PML.nr.37/2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i për bërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Avdi Dinaj dhe Valdete Daka, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit Z. S. nga Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale – dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimet nga neni 215 par. 1 të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit Z. S., E. Q., av. nga Gjilani, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për krime të rënda Gjilan, Pkr.nr.688/2013 datë 10.12.2014, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit – Departamentit për krime të rënda Prishtinë, PAKR.nr.127/2015 datë 28.10.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur më 24 shkurt 2016, mori këtë:

A K T GJ Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit Z. S., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për krime të rënda Gjilan, Pkr.nr.688/2013 datë 10.12.2014, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit – Departamentit për krime të rënda Prishtinë, PAKR.nr.127/2015 datë 28.10.2015.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-Departamenti për krime të rënda Gjilan, Pkr.nr.688/2013 datë 10.12.2014, i dënuari Z. S. është shpallur fajtor për veprën penale dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimet nga neni 215 par. 1 të KPK dhe për këtë vepër penale iu është shqiptuar dënimi i kushtëzuar duke ia përcaktuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari brenda dy vitesh nuk kryen vepër të re penale. Është detyruar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe 25 € në emër të shumës paushalle.

Ky aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit – Departamentit për krime të rënda Prishtinë PAKR.nr.127/2015 datë 28.10.2015.

Kundër këtyre aktgjykimeve mbrojtësi i të dënuarit ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së Ligjit penal me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen, i dënuari të lirohet nga akuza.

Prokurori i Shtetit të Kosovës me parashtresën KMLP.II.nr.29/2016 datë 15.2.2016, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes konform dispozitës së nenit 485 të KPPK, vlerësoi thëniet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, nuk është e bazuar.

Në kërkesën e ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit pretendohet se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 pika 12 dhe par. 2 pika 2 lidhur me nenin 370 të KPPK-së, sepse dispozitivi është i pakuptueshëm, kundërthënës me gjendjen faktike për faktin se provat e administruara nuk reflektojnë të thënat në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë. Konsideron se gjykata e shkallës së parë të dënuarin e ka shpallur fajtor duke bërë përshkrimin e tërësishëm të

deklaratave, pa analizuar mbrojtjen e të dënuarit dhe mbrojtësit të tij. Më tutje, në kërkesë thekson se aktgjykimet e kundërshtuara mbështeten vetën në deklaratën e të dëmtuarit e që konform dispozitës së nenit 262 të KPPK-së, aktgjykimi nuk mund të mbështetet vetëm në një provë.

Sa i përket shkeljeve të Ligjit penal konsideron se i dënuari nuk ka ndërmarrë asnjë veprim siç përshkruhet në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë për çka propozon që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen, i dënuari të lirohet nga akuza.

Gjykata Supreme vlerëson se pretendimet e cekura në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë qenë të theksuara edhe në ankesën e ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit kundër aktgjykimit të shkallës së parë, por gjen se këto pretendime janë të pabazuara nga këto arsye:

Në mbështetje të provave të administruara, në këtë çështje penale, gjykata e shkallës së parë me pa mëdyshje ka vërtetuar rrethanat se gjatë muajit nëntor të vitit 2013 janë zhvilluar garat për balotazh për zgjedhjet lokale në Komunën e Parteshit dhe atë në mes të dy subjekteve politike...., ku kandidat ka qenë D. N. dhe partisë politike .... me kandidatin N. C..

Nuk janë kontestuese rrethanat se nga deponimet e të dëmtuarit L. S., i cili është nga, Komuna e Parteshit, rreth orës 14,30 minuta të datës 22 nëntor 2013 , në shtëpinë e tij ka shkuar Z. S., i cili i ka ofruar 20.000 (njëzetmijë) dinarë që të votojë për partinë politike ..., ndërsa nëse nuk pranon , i njëjti do të largohet nga fshati, me ç'rast i pandehuri Z. kishte dhe një listë me emra të personave që u jepte të holla. Meqë i njëjti nuk pranon që të votojë për partinë politike ...., duke i thënë të dënuarit se i përket partisë politike ...., nga i dënuari kërcënohet me fjalë "do të votosh për kandidatin e listës politike .... ose do të shpërngulesh për Shqipëri, me ç'rast i dënuari refuzon t'i jep të holla dhe largohet nga vendi i ngjarjes.

Po ashtu, edhe dëshmitari J. S. vërteton rrethanat se nga subjekti politik .... ka qenë i ftuar me ç'rast gjoja se është regjistruar për ndihmë sociale në selinë subjektin .... nga i dënuari Z. , me pseudonim "tollumba", merr të hollat në shumë prej 20.000 (njëzetmijë) dinarë duke mohuar faktin se këtë e ka bërë për votimin e partisë politike .....

Nga lista e cila gjendet në shkresat e lëndës vërtetohen rrethanat se i dënuari se i njëjti ka përpiluar listën e personave , të cilëve u ka dhënë të holla në shumë prej nga 20.000(njëzetmijë) dinarë duke e regjistruar dhe numrin e lejes së njoftimit, mirëpo, mohon faktin se këto të holla janë dhënë për votim të subjektit politik duke theksuar se këto janë ndihma të përkohshme të qytetarve.

Qëndron fakti se aktgjykimi mbështetet në deklaratën e të dëmtuarit L. S., por kjo nuk është provë e vetme dhe e izoluar. Jo vetëm për faktin se i dëmtuari në të gjitha fazat e procedurës në mënyrë të detajuar dhe identike përshkruan rrethanat e rastit të ndodhur dhe kërcënimet të drejtuara nga i dënuari, por kjo vërtetohet edhe me listën e përpiluar nga ana e të dënuarit në selinë e subjektit politik .... ngase, kjo listë nuk mund të konsiderohet si dhënie e ndihmave të parakohshme sociale ngase për dhënien e ndihmës sociale është i autorizuar i cili bën shpërndarjen e tyre.

Prandaj, në mbështetje të gjithë kësaj dhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate rezulton se përfundimet e gjykatave janë të bazuara në provat e administruara, se në gjithë këtë situatë i dënuari me dashje ka bërë regjistrimin e të dëmtuarit duke i ofruar të hollat me kushtëzim që i dëmtuari të votojë për subjektin politik të preferuar nga i dënuari.

Andaj, në mbështetje të provave të administruara nuk vihet në dilemë ndërmarrja e veprimeve inkriminuese nga ana e të dënuarit për faktin se në arsyetimin e aktgjykimeve të kundërshtuara qartë sqarohet mënyra e regjistrimit të dëmtuarit dhe personave tjerë, qëllimi i dhënies së të hollave dhe pasi i dëmtuari refuzon që të votojë për kandidatin e subjektit politik të preferuar nga i dënuari jo vetëm që nuk i jepen të hollat por, i njëjti e kërcënon me largimin e tij , për çka rastin e paraqet në organet policore.

Po ashtu pretendimi nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë përkitazi me shkeljet e Ligjit penal, siç thekson mbrojtësi i të dënuarit se i dënuari nuk ka ndërmarrë asnjë veprim siç përshkruhet në diapozitivin e aktgjykimit, janë të pa qarta për faktin se për shkeljet e Ligjit penal, për të cilat mund të paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë janë parashikuar me dispozitën e nenit 385 të KPPK-së, i cili në mënyrë taksative parasheh rastet kur një vendim gjyqësor konsiderohet se është i përfshirë me këto shkelje, ndërsa në kërkesë nuk precizohet se për cilat shkelje bëhet fjalë. Vlen të theksohet se cilësimi juridik i veprës penale është rezultat i vërtetimit

të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, për çka pretendimet se është shkelur Ligji penal në dëm të të dënuarit, është qartazi i pabazë.

Nga arsyet e cekura më lartë e konform dispozitës së nenit 437 të KPPK-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit, është refuzuar si e pabazë dhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

PML.nr.37/2016 datë 24 shkurt 2016

Procesmbajtëse, Kryetare e kolegjit,

Qefsere Berisha Emine Mustafa